

LETËR GARANCIA


Letër Garancia është një angazhim i pakthyeshëm me shkrim, lëshuar nga një Institucioni Financiar 'Garantuesi', në emër të aplikantit dhe në favor të përfituesit, për të kryer pagesën deri në shumën e garantuar, kundrejt kërkesës me shkrim të përfituesit në rastin e mospërbushjes së detyrimit objekt i kësaj garancie.

Letër Garancia është e pavarur nga marrëveshja bazë e biznesit midis aplikantit dhe përfituesit. Fakti që marrëveshja bazë referohet në tekstin e Letër Garancisë për qëllim identifikimi, nuk e ndryshon natyrën e pavarur të saj.


MËNYRAT E LËSHIMIT TË LETËR GARANCIVE

- **Letër Garanci direkte** – lëshohen në emër të aplikantit drejtpërdrejtë tek përfituesi
- **Letër Garanci** (e aplikueshme vetëm për Institucionet Financiare Banka) – në këtë rast banka e aplikantit paraqet një kërkesë pranë një banke korrespondente për lëshimin e një garancie në favor të përfituesit, kundrejt kundërgarancisë së lëshuar në favorin e bankës korrespondente.

Leter Garancia Direkte



Leter Garancia Indirekte



LLOJET KRYESORE TË LETËR GARANCIVE

- **Garanci Pagese** – lëshohet për llogari të aplikantit për të garantuar pagesën e mallrave dhe shërbimeve në favor të përfituesit.
- **Garanci për pagesë paraprake** – lëshohet për llogari të aplikantit për të garantuar përdorimin e shumës së parapaguar në përputhje me kontratën.
- **Garanci Oferte** - lëshohet për llogari të aplikantit për pjesëmarrje në tender.
- **Garanci Kontrate** - lëshohet për llogari të aplikantit për të garantuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Garancitë Bankare janë subjekt i Rregullave Uniforme për Garancitë Bankare (Uniform Rules for Demand Guarantees), Publikimi Nr. 758 i i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, i cili zëvendësoi rregulloren e mëparshme URDG Nr. 458. Megjithatë URDG Nr.458 nuk përjashtohet nga përdorimi, nëse palët e përfshira bien dakort për përdorimin e saj.

Kolaterali i nevojshëm dhe kostot do të vlerësohen rast pas rasti. Për më shumë informacion, ju lutemi të drejtoheni pranë sporteleve të bankave.